



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 5 tetor 2017
Nr. ref.:RK 1130/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI49/17

Parashtrues

Imer Syla

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 227/2016, të 3 tetorit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Imer Syla, me banim në Ferizaj (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga Labinota Qosa-Ilazi.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [Pml. nr. 227/2016] të 3 tetorit 2016, të Gjykatës Supreme të Kosovës, , të cilin parashtruesi i kërkesës e ka pranuar më 17 nëntor 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] si dhe neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafët 1 dhe 7 të Kushtetutës, në nenin 47 [Kërkesë Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 20 prill 2017, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 24 prill 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Ivan Cukalović (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.
7. Më 28 prill 2017, Gjykata e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës si dhe i dërgoi një kopje të saj Gjykatës Supreme.
8. Më 7 shtator 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 11 mars 2013, Prokuroria Themelore në Ferizaj ka ngritur aktakuzën [PP. II. nr. 847-5/2010] ndaj parashtruesit të kërkesës për kryerjen e veprës penale "*shkaktim i rrezikut të përgjithshëm*" në bazë të nenit 291, të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPK).
10. Më 30 korrik 2014, Gjykata Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, pas pranimit të fajësisë gjatë shqyrtimit fillestar nga parashtruesi i kërkesës, përmes Aktgjykimit [P. nr. 635/13] e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor, duke i shqiptuar dënim me gjobë dhe dënim me burg në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh, duke theksuar se dënimi nuk do të

ekzekutohet në afat prej 2 (dy) vitesh me kusht që i akuzuari, përkatësisht parashtruesi i kërkesës, gjatë kësaj periudhe nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

11. Më 10 mars 2016, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për rishikim të procedurës penale në Gjykatën Themelore në Ferizaj ndaj Aktgjykimit [P. nr. 635/13] të Gjykatës Themelore në Ferizaj, të 29 korrikut 2014, duke pretenduar vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, ekzistimin e provave të reja, si dhe duke argumentuar se parashtruesi i kërkesës *“pranimin e fajësisë e ka bërë pa e kuptuar natyrën e veprës penale”*, dhe se rrjedhimisht, nuk janë plotësuar kushtet ligjore për pranimin e fajësisë gjatë shqyrtimit fillestarë.
12. Më 14 prill 2016, Gjykata Themelore në Ferizaj përmes Aktvendimit [PK. nr. 42/16], refuzon si të palejueshme kërkesën e parashtruesit, duke vlerësuar se faktet dhe provat e paraqitura nuk ofrojnë bazë ligjore për të lejuar rishikimin e procedurës penale.
13. Më 18 prill 2016, parashtruesi i kërkesës ka parashtruar ankesë ndaj Aktvendimit [PK. nr. 42/16] të Gjykatës Themelore në Ferizaj, të 14 prillit 2016, duke pretenduar shkeljen e të drejtës thelbësore të palës të paraparë me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPPK).
14. Më 18 korrik 2016, Gjykata e Apelit e Kosovës përmes Aktvendimit [PN. nr. 485/2016], refuzon si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës. Gjykata e Apelit në aktvendimin e saj ka dhënë përgjigje të detajuar në të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës.
15. Më 17 gusht 2016, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktvendimit [PN. nr. 485/2016] të Gjykatës së Apelit të Kosovës, të 18 korrikut 2016, me propozim që i njëjti të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim.
16. Më 3 tetor 2016, Gjykata Supreme e Kosovës përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 227/2016], e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë. Në arsyetim të këtij aktgjykimi, ndër të tjera, thuhet: *“[...] si në aktvendimin e shkallës së parë ashtu edhe në atë të shkallës së dytë, janë dhënë arsye ligjore për marrjen e vendimeve të kundërshtuara [...] me të drejt është konstatuar në aktvendimin e shkallës së parë se prova në të cilën bazohet kërkesëpadia për rishikimin e procedurës penale [...] nuk justifikon lejimin e rishikimit të procedurës penale e këtë e ka aprovuar edhe gjykata e shkallës së dytë”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin [Pml. nr. 227/2016] të 3 tetorit 2016, të Gjykatës Supreme të Kosovës, i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] si dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
18. Argumentet e parashtruesit të kërkesës në raport me pretendimet e tij për shkelje kushtetuese, janë si në vijim: *“i është shkelur përfundimisht e drejta*

për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, e drejtë kjo e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kurse nëse rasti analizohet që nga fillimi, duke marrë për bazë shkollimin që ka Imer Syla [...] del çartë se në raport me Imer Sylën, organet kompetente gjatë procedimit të çështjes penale konkrete kundër Imer Sylës, kanë shkelur par.5 të nenit 30, par 1 dhe 6 të nenit 31 dhe nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për arsye se përveç se nuk ka asnjë provë të vetme, e cila dëshmon se Imer Syla është pronar i patundshmërisë në të cilin ka ndodhur vepra penale [...] gjykata e shkallës së parë pa prezencën e avokatit nuk ka pasur të drejtë të pranoj, pranimin e fajsisë së Imer Sylës ”.

19. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që t'i shfuqizojë vendimet e gjykatave të rregullta.

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafëve 1 dhe 7, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

22. Gjykata, gjithashtu, i referohet nenit 49 të Ligjit [Afatet], i cili përcakton:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor”.

23. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 36 [Kriteret e pranueshmërisë] (1) (c) të Rregullores së punës, me të cilin theksohet që:

“(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

[...] (c) kërkesa parashtrohet brenda 4 (katër) muajsh nga dita e dorëzimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi; ose [...]”.

24. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës më 17 nëntor 2016, derisa kërkesa është dorëzuar në Gjykatë më 20 prill 2017. Rrjedhimisht, kërkesa është dorëzuar në Gjykatë jashtë afatit ligjor 4 (katër) muajor.

25. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor 4 (katër) mujor, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri ligjore, duke siguruar se rastet që kanë të bëjnë me çështje të Kushtetutës të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme, dhe se vendimet e mëparshme të mos jenë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar. (Shih rastin *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aplikacioni nr. 23274/04, GJEDNJ, Aktvendimi i 25 gushtit 2005 dhe po ashtu, shih rastin nr. KI140/13, *Ramadan Cakiqi*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 marsit 2014, paragrafi 24).
26. Përveç kësaj, Gjykata thekson se afati ligjor 4 (katër) mujor llogaritet nga dita kur parashtruesi i kërkesës ka pranuar, pas shterimit të mjeteve juridike, vendimin e kontestuar. (Shih, për shembull, rastin *Hatip Çelik kundër Turqisë*, GJEDNJ, aplikacioni nr. 52991/99, Aktvendim i 23 shtatorit 2004).
27. Gjykata thekson se është detyrë e parashtruesve të kërkesave apo përfaqësuesve të tyre që të veprojnë me 'kujdes të nevojshëm' (*due diligence*) për t'u siguruar se kërkesat e tyre për mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore janë dorëzuar brenda afatit ligjor 4 (katër) mujor, të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe specifikuar më tej me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës. (Shih rastin *Mocanu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, [DHM], aplikacionet nr. 10865/09, 45886/07 dhe 32431/08, Aktgjykimi i 17 shtatorit 2014, paragrafët 263-267).
28. Rrjedhimisht, kërkesa deklarohet e papranueshme për shkak se nuk është dorëzuar brenda afatit, siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, siç parashihet me nenin 49 të Ligjit dhe specifikohet më tej me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, më 7 shtator 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Gresa Caka-Nimani
Gresa Caka-Nimani



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi
Arta Rama-Hajrizi